



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Roskovec ,më 17.04 .2020

Lënda: Raport për transparencën në procesin e vendimmarrjes nga Këshilli i Bashkisë Roskovec për vitin 2019

Të nderuar këshilltarë,

Këshilli i Bashkisë Roskovec i kryen funksionet e tij duke u mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe Rregullores së brendshme të funksionimit të këshillit bashkiak.Këshilli ka ngritur edhe Komisionet e tij të Përherëshme të cilët mblidhen sipas rasteve që paraqiten.

Gjatë vitit 2019 këshilli është fokusuar në trajtimin e problemeve dhe shqetësimeve që meritonin një vëmendje më të madhe për një shërbim cilësor dhe sa më afër komunitetit.Në mbledhjet e këshillit janë trajtuar vendime të rëndësishme që kishin një impakt të fuqishëm në lidhje me përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve në qytet dhe fshatra.Prioritare kanë qënë vendimet që i kushtoheshin zgjidhjes së problemeve për familjet me probleme të thella sociale.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2019 janë marrë gjithësej 117 (një qind e shtatëmbëdhjetë) vendime në Këshillin e Bashkisë Roskovec.Krahasuar me vendimmarrjen e vitit 2018 gjatë vitit 2019 janë marrë 10 vendime më shumë,pasi në vitin 2018 ishin marrë gjithësej 107 vendime.

Janë organizuar dhe zhvilluar 15 mbledhje këshilli të cilat kanë qënë të gjitha mbledhje të hapura për publikun.Njoftimet e mbledhjeve dhe publikimi e afishimi i tyre është bërë sipas kriterëve që përcakton ligji.

Vetëm 8 (tetë) Vendime nuk janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier,dhe në bazë të procedurës ligjore këto vendime janë anuluar po me vendim këshilli.Vlen për tu theksuar se me tepër se 99% e vendimeve kanë qënë konform ligjeve dhe vendimeve të qeverisë pasi për të gjitha këto vendime Prefektura e Qarkut Fier është shprehur pozitivisht për shprehjen e ligjshmërisë ndaj tyre.Vendimet e miratuara sipas objektit të tyre u janë shpërndarë administratës së bashkisë për zbatim.

Nisur nga karakteri i vendimeve të miratuara mund ti ndajmë në vendime të miratuara për problemet sociale 40 vendime,për problemet financiare 18 vendime,për infrastrukturën 17 vendime,probleme urbane 7 vendime,për arsimin & kulturën 5 vendime,konstituimi dhe zgjedhja e organeve drejtuese të këshillit 9 vendime,dhe pjesa tjetër e vendimeve pra 21 prej tyre kanë qënë të problematikave të ndryshme.Nga sa më sipër vlen të theksohet se këshilli bashkiak ka trajtuar dhe i ka dhënë zgjidhje një game të gjerë problematikash të komunitetit tonë në fusha të ndryshme si :për të ardhurat e veta,për fondet buxhetore,për ndihmat ekonomike,për shërbime ndaj komunitetit,investime ndaj komunitetit etj..Zgjidhja e këtyre problemeve vjen dhe si rezultat i një bashkëpunimi shumë të mirë me Ekzekutivin dhe administratën e Bashkisë Roskovec,të cilët kanë si objekt të përbashkët zgjidhjen në kohë dhe sipas ligjit gjithë shqetësimet dhe problematikat e komunitetit të Bashkisë Roskovec.

Të gjitha vendimet e këshillit janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec.

Gjatë vitit 2019 Këshilli i Bashkisë në bashkëpunim edhe me administratën e bashkisë kanë organizuar dhe zhvilluar gjithësej 13 (trembëdhjetë) dëgjesa publike me komunitetin dhe grupet e interesit në Roskovec dhe në fshatrat e Njësi Administrative.Në këto dëgjesa kanë marrë pjesë anëtarë të këshillit,anëtarë të komisioneve të këshillit dhe sekretarja e këshillit për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve.

Në dëgjesat e zhvilluara janë bërë propozime dhe sugjerime shumë të vlefshme,kryesisht për buxhetin dhe paketën fiskale.Këshilli dhe Bashkia kanë vlerësuar sugjerimet dhe propozimet e bëra nga qytetarët dhe janë angazhuar që ato të pasqyrohen në vendimmarrje.

Me miratimin në Këshill të tre rregulloreve:1 “Rregullore për funksionimin e Këshillit të Bashkisë Roskovec”,2 “Rregullore e Këshillit Bashkiak për konsultimet publike” ,3 “Kodit të Sjelljes dhe të Parandalimit të Konfliktit të Interesave të këshilltarit bashkiak” jemi optimist se do të përmirësohet edhe më shumë veprimtaria e pergjithshme e këshillit si dhe zhvillimi i dëgjesave publike.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!

Konceptoi: Sekretar i Këshillit
Arlinda Hajdini

KRYETAR

Kadri Hyska

